



Pranuar / Dorezuar Prijemno/Prudato Received/Deliverty	21-05	2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/MBHC	2574/2021		1/3	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. nr.275/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj -Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.275/2021 të datës 15.04.2021 të parashtruar nga me adresë banimi fshati Gadime, Babush, Komuna e Lipjanit, kundër Vendimit më numër KA.nr.12/2021 të datës 26.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A. nr.275/2021 e datës 15.04.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja Zyrtare Ligjore në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan, më datë 08.04.2021 ka parashtruar përmes postes së Kosovës ankesë me numër protokollit 1793/2021 e regjistruar me A.nr.275/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit më numër KA.nr.12/2021 të datës 26.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 19.04.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli më datë 27.04.2021 ka pranuar

nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 15.04.2021 e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 1793/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; vendimin me nr.KA.nr.12/2021 të datës 26.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ankesën e datës 12.02.2021 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin me numër reference DS-25/2021 të datës 18.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Përgjigjen në ankesë e datës 27.04.2021, Emalin e datës 20.01.2021 lidhur njoftimin e Vendimit me numër refernce DS-25/2021 të datës 18.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Certifikatën e Lindje L 23935942 të datës 27.10.2020 , Certifikatë e Vdekjes V 10360932 të datës 27.10.2020, E-maili i datës 12.05.2021 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ se bashku me shkresat nga numër 1 deri 6, dëshmi postare lidhur me dorëzimin e ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se ankesa e ankueses \_\_\_\_\_ është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji rezulton se ankuesja e punësuar në pozitën e Zyrtares Ligjore në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan, me datë 08.01.2021 i është drejtuar më kërkesë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (me tej SKGJK) për ndihmë me rastin e vdekjes së vëllait të saj.

Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së përmes Vendimit me numër reference DS-25/2021 të datës 17.01.2021, ka refuzuar ankesën e ankueses të datës 08.01.2021. Ankuesja e pakënaqur me këtë vendim ushtron ankesë me datë 12.02.2021 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, ku i njëjti me Vendimin KA.nr.12/2021 të datës 26.02.2021, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankueses, ndërsa ankuesja lidhur me Vendimin KA.nr.12/2021 të datës 26.02.2021, është njoftuar me datë 26.02.2021 përmes e-mailit zyrtar.

Kundër Vendimit KA.nr.12/2021 të datës 26.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, ankuesja me datë 08.04.2021, përmes postes së Kosovës ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e pranuar në Këshill me datë 15.04.2021, me pretendimin ankimor se vendimi i atakuar me ankesë është nxjerr me shkelje të dispozitave procedurale si dhe aplikim të gabuar të dispozitave materiale. E mbi këtë bazë propozon që Këshilli të aprovoj si të bazuar ankesën dhe të ndryshoj vendimin e shkallës së parë ashtu që ankueses ti njoh të drejtën e kompensimit të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Në vështrim të dispozitave ligjore të nenit 50 paragrafi 1 dhe nenit 81 paragrafi 2 nen paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, çdo nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 paragrafi 1 është përcaktuar se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga*



data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjdhjes së Kontesteve dhe të Ankesave përkatësisht neni 8 paragrafi 2 shprehimisht thuhet se : Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës, Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht në njoftimin e datës 26.02.2021 të ankueses lidhur me Vendimin e kontestuar me ankesë, Kolegji konstaton se ankesa e parashtruar në postë me datë 08.04.2021, është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative si dhe neni 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjdhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda Nr. A. Nr. 275/2021

  
Ruzhita KAJTAZI  
Procesmbajtës

  
Ardita HAXHNIKAJ DEMI  
Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariati të Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së,

